

RELACION TEKNIK VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

STUDIM-PROJEKTIM: SISTEMIMI I PERRENJVE
HIMARE

Projektues: **BOE “INFRATECH” sh.p.k & “EMAR 21” sh.p.k**
Perfaqesues me prokure: **Ing. Filjana Veizaj**

PËRMBAJTJA

PERSHKRIMI I PROJEKTIT	3
QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR	3
PLANIMETRIA E VENDNDODHJES SE PROJEKTIT	3
PERSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE	4
INFORMACION PER QENDRAT E BANUARA	5
INFORMACION I DETAJUAR	6
LENDET E PARA TE PERDORURA	7
PREVENTIVI I PUNIMEVE TE PARASHIKUARA	7
INFRASTRUKTURA E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETET DHE AKSESIN	8
PROGRAMI PER NDERTIMIN, KOHEZGJATJEN E NDERTIMIT, KOHEZGJATJA E PLANIFIKUAR E FUNKSIONIMIT TE PROJEKTIT	9
INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KONSIDERATE PERSA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO PERDORET	9
AKTIVITETE TE TJERA QE MUND TE NEVOJITEN PER ZBATIMIN E PROJEKTIT	10
INFORMACION PER LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENSAT E NEVOJSHME PER PROJEKTIN SI DHE KOPJE TE TE GJITHE AUTORIZIMEVE, LEJEVE DHE LICENSAVE QE SHOQERIA DISPONON	11

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Qëllimi i projektit të propozuar është rehabilitimi dhe sistemimi i segmentit ekzistues të përroit në zonën e Potamit, Bashkia Himarë, me synim rritjen e sigurisë hidraulike, mbrojtjen e territorit nga përmytjet dhe erozioni, si dhe përmirësimin e kushteve mjedisore në zonë. Projekti synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe afatgjatë për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore, duke garantuar përcjelljen e sigurt të prurjeve gjatë episodeve të reshjeve intensive dhe duke reduktuar rrezikun e dëmtimeve ndaj infrastrukturës publike dhe pronave private.

Në kuadër të këtij objekti, projekti parashikon rritjen e kapacitetit përcjellës të përroit nëpërmjet sistemimit të shtratit, profilizimit të seksionit hidraulik dhe ndërtimit të strukturave mbrojtëse të brigjeve. Këto ndërhyrje do të mundësojnë kontrollin e rrjedhjes së ujërave, përmirësimin e funksionimit hidraulik të përroit dhe eliminimin e problematikave që lidhen me daljen e ujit nga shtrati gjatë prurjeve të larta.

Njëkohësisht, projekti synon stabilizimin e brigjeve të përroit dhe frenimin e proceseve erozive që kanë shkaktuar degradimin e tyre ndër vite. Nëpërmjet realizimit të veprave mbrojtëse do të sigurohet mbrojtja e territorit përreth, ruajtja e integritetit të infrastrukturës ekzistuese dhe minimizimi i rreziqeve që lidhen me gërryerjet dhe shembjet lokale.

Në aspektin mjedisor, projekti kontribuon në përmirësimin e gjendjes së territorit përmes pastrimit dhe sistemimit të shtratit të përroit, eliminimit të depozitimeve të pakontrolluara të materialeve inerte dhe krijimit të kushteve për një rrjedhje më të kontrolluar dhe më të qëndrueshme të ujërave. Kjo do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e degradimit të mjedisit dhe në përmirësimin e cilësisë së hapësirës urbane.

Zbatimi i projektit do të sigurojë një infrastrukturë hidroteknike funksionale, të sigurt dhe të qëndrueshme në kohë, duke rritur nivelin e mbrojtjes së zonës ndaj fenomeneve natyrore dhe duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe mirëqenien e komunitetit lokal.

PLANIMETRIA E VENDNDODHJES SE PROJEKTIT

Projekti është planifikuar në territorin administrativ të Bashkisë Himarë dhe përfshin segmentin e përroit në zonën e Potamit, i cili shtrihet nga rruga nacionale në drejtim të kryqëzimit me rrugën e By-pass-it të Himarës. Gjurma e ndërhyrjes ndjek shtratin ekzistues të përroit dhe është përshtatur me konfigurimin natyror të terrenit, karakteristikat topografike të zonës dhe zhvillimin urban përreth.

Sipas planimetrisë së projektit, ndërhyrja është konceptuar duke respektuar gjurmën ekzistuese të përroit, me qëllim minimizimin e ndërhyrjeve në territor dhe integrimin e veprave të reja me elementët ekzistues të infrastrukturës. Zona ku zhvillohet projekti ndodhet pranë sipërfaqeve të banuara dhe infrastrukturës rrugore, të cilat janë të ekspozuara ndaj efekteve të erozionit dhe prurjeve të larta gjatë periudhave me reshje intensive.

Nga analiza e planimetrisë, ortofotove dhe rievimeve topografike rezulton se segmenti aktual i përroit paraqet seksione të paunifikuara, depozitime sedimentesh dhe materialesh inerte, si dhe mungesë të strukturave të qëndrueshme mbrojtëse në pjesën më të madhe të gjatësisë së tij. Në disa segmente brigjet paraqiten të dëmtuara nga proceset erozive, duke krijuar rrezik për degradimin e mëtejshëm të territorit dhe cenimin e infrastrukturës pranë përroit.

Vendndodhja e zgjedhur për ndërhyrje paraqet rëndësi të veçantë për sigurinë hidraulike të zonës, pasi përroi shërben si kolektor natyror i ujërave sipërfaqësore që shkarkohen nga pellgu ujëmbledhës përkatës. Në kushtet aktuale, mungesa e sistemimit të plotë dhe kapaciteti i kufizuar i seksioneve ekzistuese krijojnë rrezik për dalje të ujërave nga shtrati, përmytje lokale, gërryerje të brigjeve dhe dëmtime të infrastrukturës ekzistuese.

Pozicioni i projektit siguron kushte të favorshme për realizimin e veprave të sistemimit, akses të përshtatshëm për zbatimin e punimeve dhe mundësi të mira për mirëmbajtjen e tyre në të ardhmen. Për këtë arsye, zgjidhja e propozuar konsiderohet teknikisht e përshtatshme dhe funksionale, duke garantuar përmirësimin e sigurisë hidraulike, mbrojtjen e territorit dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës në zonën e Potamit, Bashkia Himarë.

PERSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE

Zona ku propozohet realizimi i projektit ndodhet në territorin administrativ të Bashkisë Himarë, në zonën e Potamit, dhe përfshin segmentin ekzistues të përroit që shtrihet nga rruga nacionale në drejtim të kryqëzimit me rrugën e By-pass-it të Himarës. Ky segment përbën një nga kolektorët natyrorë të ujërave sipërfaqësore të zonës dhe luan rol të rëndësishëm në shkarkimin e prurjeve gjatë periudhave me reshje intensive.

Nga vëzhgimet dhe inspektimet e kryera në terren rezulton se përroi ndodhet në gjendje të amortizuar dhe pjesërisht të degraduar. Shtrati i tij paraqet seksione të parregullta, me depozitime sedimentesh, materialesh aluvionale dhe inertesh të akumuluar ndërmjet viteve, të cilat kanë reduktuar ndjeshëm kapacitetin përcjellës të ujërave. Në disa segmente vërehen procese të avancuara erozioni, dëmtime të brigjeve dhe degradim i skarpave natyrore, duke krijuar kushte të pafavorshme për funksionimin normal të përroit.

Strukturat ekzistuese mbrojtëse janë të pamjaftueshme ose mungojnë pothuajse plotësisht në pjesën më të madhe të segmentit. Elementët e mbrojtjes që kanë ekzistuar më parë paraqiten të dëmtuar dhe të amortizuar, ndërsa në disa zona janë shkatërruar pothuajse tërësisht si pasojë e veprimtari të ujërave dhe mungesës së mirëmbajtjes. Si rezultat, brigjet e përroit janë të ekspozuara ndaj gërryerjeve të vazhdueshme dhe humbjes progresive të stabilitetit të terrenit.

Gjatë periudhave me reshje intensive, segmenti ekzistues paraqet rrezik të lartë për dalje të ujërave nga shtrati, duke shkaktuar përmytje lokale, dëmtime të tokës, cenim të infrastrukturës ekzistuese dhe rrezik për pronat që ndodhen në afërsi të përroit. Kapaciteti aktual hidraulik nuk është i mjaftueshëm për të garantuar shkarkimin e sigurt të prurjeve maksimale, çka e bën të domosdoshme ndërhyrjen për sistemimin e tij.

Nga pikëpamja mjedisore, zona karakterizohet nga prania e bimësisë spontane dhe e depozitimeve të ndryshme të materialeve të transportuara nga rrjedhjet sipërfaqësore. Mungesa e sistemimit

hidroteknik ka favorizuar akumulimin e materialeve në shtrat dhe ka përkeqësuar funksionimin e përroit gjatë ngjarjeve me reshje të dendura.

Në tërësi, gjendja ekzistuese e segmentit paraqet nevojë të qartë për ndërhyrje rehabilituese dhe mbrojtëse, me qëllim sistemimin e shtratit, stabilizimin e brigjeve, rritjen e kapacitetit hidraulik, mbrojtjen e territorit përreth dhe garantimin e funksionimit të sigurt të përroit në afatgjatë.

INFORMACION PER QENDRAT E BANUARA

Zona ku propozohet realizimi i projektit ndodhet në zonën e Potamit, pjesë e territorit administrativ të Bashkisë Himarë. Kjo zonë përbën një nga hapësirat më të rëndësishme urbane dhe turistike të qytetit të Himarës, e karakterizuar nga zhvillim i vazhdueshëm i banimit, shërbimeve dhe aktiviteteve turistike. Relievi i territorit është kryesisht kodrinor-malor, me pjerrësi të konsiderueshme dhe me prani të rrjedhjeve sipërfaqësore që shkarkohen drejt vijës bregdetare.

Zona e Potamit ndodhet pranë akseve kryesore të qarkullimit dhe përfshin banesa, struktura shërbimi, aktivitete tregtare dhe objekte të lidhura me sektorin e turizmit. Zhvillimi i shpejtë urban i viteve të fundit ka rritur kërkesat për infrastrukturë më të sigurt dhe më funksionale, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes nga përmbytjet dhe kontrollit të ujërave sipërfaqësore.

Segmenti i përroit që përfshihet në projekt kalon pranë zonave të banuara dhe infrastrukturës ekzistuese, duke shërbyer si kolektori kryesor i ujërave që krijohen në pellgun ujëmbledhës përkatës. Për shkak të degradimit të brigjeve dhe mungesës së sistemimit të plotë, përroi paraqet rrezik të vazhdueshëm për territorin përreth, veçanërisht gjatë periudhave me reshje intensive, kur prurjet e larta mund të shkaktojnë gërryerje, dëmtime të infrastrukturës dhe probleme për banorët e zonës.

Nga pikëpamja infrastrukturore, zona është e lidhur me rrjetin ekzistues rrugor të qytetit të Himarës dhe gëzon akses të mirë për banorët dhe vizitorët. Në afërsi të segmentit të projektit ndodhen banesa dhe elementë të ndryshëm të infrastrukturës publike, të cilët kërkojnë mbrojtje dhe siguri më të lartë ndaj fenomeneve natyrore.

Nga aspekti mjedisor dhe peizazhist, zona karakterizohet nga vegjetacion tipik mesdhetar dhe nga peizazhi karakteristik bregdetar i Himarës. Projekti është konceptuar në mënyrë që të integrohet me karakteristikat natyrore të territorit, duke minimizuar ndikimet në mjedis dhe duke siguruar përmirësimin e sigurtisë hidraulike dhe mbrojtjen afatgjatë të zonës.

POPULLSIA

Zona e Potamit shërbehet nga popullsia rezidente e qytetit të Himarës, e cila gjatë viteve të fundit është shoqëruar me rritje të aktivitetit ekonomik dhe turistik. Bashkia Himarë përfaqëson një nga destinacionet më të rëndësishme turistike të bregdetit shqiptar dhe gjatë sezonit veror përjeton një rritje të konsiderueshme të popullsisë faktike për shkak të pranisë së turistëve vendas dhe të huaj.

Popullsia e zonës përfiton drejtpërdrejt nga infrastruktura rrugore dhe hidroteknike që ndodhet pranë segmentit të projektit. Banesat, aktivitetet e shërbimit dhe funksionet e tjera urbane varen nga funksionimi i sigurt i këtij territori, veçanërisht gjatë periudhave me reshje intensive kur rritet rreziku i përmbytjeve dhe erozionit.

Zhvillimi i vazhdueshëm urban dhe rritja e fluksit të vizitorëve kanë shtuar nevojën për investime në infrastrukturë mbrojtëse dhe sistemim të ujërave sipërfaqësore. Për këtë arsye, projekti paraqet një ndërhyrje me rëndësi të veçantë për komunitetin lokal, pasi kontribuon në mbrojtjen e banesave, të infrastrukturës ekzistuese dhe të hapësirave publike nga efektet e fenomeneve natyrore.

Realizimi i investimit do të ketë ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë mbi banorët dhe përdoruesit e zonës, duke rritur sigurinë publike, duke reduktuar rrezikun e dëmtimeve nga përmbytjet dhe erozioni, si dhe duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm urban, ekonomik dhe turistik të qytetit të Himarës.

INFORMACION I DETAJUAR

Projekti është hartuar me qëllim rehabilitimin dhe sistemimin e plotë të segmentit ekzistues të përroit në zonën e Potamit, Bashkia Himarë, duke rritur nivelin e sigurisë hidraulike dhe duke mbrojtur territorin, infrastrukturën ekzistuese dhe pronat që ndodhen përgjatë tij. Zgjidhja e propozuar është bazuar në studimet topografike, hidrologjike dhe gjeologo-inxhinierike të kryera në zonë, si dhe në analizën e problematikave ekzistuese që lidhen me erozionin, degradimin e brigjeve dhe kapacitetin e pamjaftueshëm të seksionit hidraulik.

Punimet do të fillojnë me gërmimet për sistemimin e shtratit të përroit dhe krijimin e seksioneve projektuese, duke mundur largimin e depozitimeve ekzistuese, profilizimin e seksionit hidraulik dhe përgatitjen e bazamenteve për strukturat mbrojtëse. Materialet e dala nga gërmimet do të transportohen dhe depozitohen në vende të miratuara, në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore.

Për sigurimin e qëndrueshmërisë së veprës janë parashikuar shtresa mbushëse me çakëll dhe zhavorr, të cilat do të shpërndahen dhe ngjeshen mekanikisht sipas specifikimeve teknike të projektit. Këto shtresa do të krijojnë bazën e nevojshme për ndërtimin e strukturave mbrojtëse dhe sistemimin e tabanit të përroit.

Elementi kryesor i projektit konsiston në ndërtimin e mureve mbrojtëse me gabiona në të dy brigjet e përroit. Gabionet do të realizohen me rrjeta teli të zinguar dhe do të mbushen me gurë natyrorë të përshtatshëm, duke krijuar një strukturë fleksibël dhe rezistente ndaj veprimit të ujit dhe proceseve erozive. Këto struktura do të sigurojnë stabilizimin e brigjeve, mbrojtjen e territorit përreth dhe disiplinimin e rrjedhës së ujërave gjatë prurjeve të larta.

Në tabanin e përroit parashikohet realizimi i shtresave të betonit, të cilët do të garantojnë qëndrueshmërinë e seksionit hidraulik dhe mbrojtjen nga gërryerjet. Strukturat do të ndërtohen mbi shtresa përgatitore dhe do të realizohen sipas kërkesave të standardeve teknike në fuqi.

Në kuadër të mbrojtjes së territorit nga efektet e ujërave sipërfaqësore, projekti përfshin sistemimin e plotë të shtratit të përroit dhe krijimin e një seksioni hidraulik të aftë për të përcjellë në mënyrë të sigurt prurjet projektuese. Ndërhyrjet e propozuara do të reduktojnë rrezikun e

përmblyjeve, do të eliminojnë proceset e gërryerjes së brigjeve dhe do të mbrojnë infrastrukturën dhe pronat që ndodhen pranë segmentit të ndërhyrjes.

Materialet e ndërtimit do të sigurohen nga burime të licencuara dhe do të jenë të pajisura me certifikatat përkatëse të cilësisë. Gjatë zbatimit të punimeve do të kryhen kontrole laboratorike dhe verifikime teknike për betonin, materialet gurore dhe elementët konstruktivë, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e projektit dhe standardet teknike në fuqi.

LENDET E PARA TE PERDORURA

Në kuadër të realizimit të projektit do të përdoren lëndë të para dhe materiale ndërtimore standarde, të siguruar nga subjekte të licencuara dhe në përputhje me specifikimet teknike të projektit. Materialet janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë strukturore, jetëgjatësinë e veprës, sigurinë hidraulike dhe përshtatjen me kushtet natyrore të zonës.

Lëndët kryesore të para që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve janë betoni, hekuri, gabionet me rrjeta teli të zinguar, çakëlli dhe zhavorri.

Gabionet me rrjeta teli të zinguar dhe mbushje me gurë natyrorë përbëjnë elementin kryesor mbrojtës të projektit. Kjo zgjidhje siguron rezistencë të lartë ndaj erozionit, aftësi të mira drenazhuese dhe integritet të përshtatshëm me mjedisin natyror të zonës.

Gjatë fazës së ndërtimit do të përdoren ujë dhe karburant për nevojat e kantierit dhe funksionimin e makinerive të ndërtimit. Ndikimet kryesore të mundshme në mjedis lidhen me krijimin e pluhurave, zhurmave, gazeve të djegies dhe rrjedhjeve aksidentale të hidrokarbureve gjatë proceseve të punës dhe transportit. Megjithatë, këto ndikime konsiderohen të përkohshme, lokale dhe të kontrollueshme, pasi gjatë zbatimit të punimeve do të merren masa mbrojtëse dhe organizative për minimizimin e tyre, si lagia periodike e sipërfaqeve për reduktimin e pluhurit, mirëmbajtja teknike dhe përdorimi i makinerive në gjendje të mirë pune, depozitimi i kontrolluar i karburanteve dhe vajrave, si dhe largimi dhe menaxhimi i mbetjeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Në tërësi, materialet e parashikuara për realizimin e projektit konsiderohen materiale standarde ndërtimore me ndikim të kufizuar dhe të menaxhueshëm në mjedis. Duke zbatuar masat teknike dhe organizative të parashikuara në raportin e VNM-së, ndikimet gjatë fazës së ndërtimit do të jenë të përkohshme, lokale dhe pa pasoja të rëndësishme afatgjata mbi mjedisin përreth.

PREVENTIVI I PUNIMEVE TE PARASHIKUARA

KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA
	1. PUNIME GERMIMI		
3.137	Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m ³ , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke	m3	5600
	SHUMA 1:		
	2. PUNIME DHEU		

2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	5600
	SHUMA 2:		
	3. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE		
2.701	Shtresë çakëlli	m3	1350
2.258/2	Shtrese zhavori	m3	585
	SHUMA 3:		
	4. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME		
3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	626
3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	939
3.336	Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave 1x1x0.5m	m3	469.5
3.688	F.V. Keson 2x2 per 1 ml	ml	6
	SHUMA 4:		
	5. PUNIME SHTRESASH 2		
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15	m3	286.5
	SHUMA 5:		
	6. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	192.6
	SHUMA 6:		
	7. PUNIME HEKUR BETONI 3		
3.287	F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	3.04
	SHUMA 7:		

INFRASTRUKTURA E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETET DHE AKSESIN

Për realizimin dhe funksionimin e projektit parashikohet krijimi i kushteve të nevojshme për aksesin e mjeteve të ndërtimit, zhvillimin e punimeve dhe mirëmbajtjen e veprës pas përfundimit të saj. Zgjidhja projektuese është hartuar duke marrë në konsideratë kushtet ekzistuese të terrenit, rrjetin rrugor të zonës së Potamit dhe nevojën për integrimin e veprës me infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Himarë.

Aksesimi i zonës së ndërhyrjes realizohet nëpërmjet rrugës nacionale dhe rrugëve ekzistuese lokale që lidhen me segmentin e përroit. Këto rrugë sigurojnë hyrjen e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe mundësojnë transportin e materialeve ndërtimore gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Gjatë punimeve do të merren masa për garantimin e qarkullimit të sigurt dhe ruajtjen e aksesit për banorët dhe përdoruesit e zonës.

Furnizimi me ujë për nevojat e kantierit do të realizohet nga burime ekzistuese të zonës ose nëpërmjet depozitave të përkohshme të ujit, sipas organizimit të punimeve. Uji do të përdoret për proceset e ndërtimit, lagjen e sipërfaqeve për reduktimin e pluhurit dhe nevojat sanitare të personelit të kantierit.

Furnizimi me energji elektrike gjatë fazës së ndërtimit do të sigurohet përmes lidhjeve të përkohshme me rrjetin ekzistues të shpërndarjes ose me gjeneratorë të lëvizshëm, në varësi të kërkesave të sipërmarrësit dhe kushteve të organizimit të kantierit.

Menaxhimi i materialeve të dala nga gërmimet dhe i mbetjeve të krijuara gjatë punimeve do të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore në fuqi. Materialet e tepërta do të transportohen në venddepozitime të miratuara, ndërsa mbetjet do të grumbullohen, sistemohen dhe largohen në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur çdo ndikim negativ në shtratin e përroit dhe territorin përreth.

Gjatë organizimit të kantierit do të merren masa për ruajtjen e sigurisë së punëtorëve dhe përdoruesve të zonës, mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndikimeve të përkohshme nga transporti, pluhuri dhe zhurmat. Materialet dhe pajisjet do të depozitohen në zona të përcaktuara paraprakisht, pa penguar rrjedhën natyrore të ujërave dhe pa dëmtuar infrastrukturën ekzistuese.

Pas përfundimit të punimeve, infrastruktura e realizuar do të integrohet plotësisht me sistemin ekzistues të drenazhimit natyror të zonës dhe me rrjetin rrugor përreth, duke siguruar funksionim afatgjatë të veprës, mbrojtje të territorit nga përmytjet dhe erozioni, si dhe përmirësim të ndjeshëm të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së zonës së Potamit në Bashkinë Himarë.

PROGRAMI PER NDERTIMIN, KOHEZGJATJEN E NDERTIMIT, KOHEZGJATJA E PLANIFIKUAR E FUNKSIONIMIT TE PROJEKTIT

Ky projekt parashikohet të realizohet brenda një periudhe prej 4 muajsh, në përputhje me grafikun e punimeve të hartuar nga projektuesi. Kohëzgjatja e punimeve është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e ndërhyrjeve, kushtet mjedisore të territorit, organizimin e kantierit dhe nevojën për minimizimin e ndikimeve. Punimet do të zhvillohen në mënyrë të fazuar dhe të kontrolluar, me qëllim garantimin e sigurisë, ruajtjen e mjedisit natyror dhe respektimin e kushteve teknike dhe mjedisore të projektit.

INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KONSIDERATE PERSA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QE DO PERDORET

Gjatë hartimit të projektit janë analizuar alternativa të ndryshme si për sa i përket vendndodhjes së ndërhyrjes, ashtu edhe zgjidhjeve teknike për sistemimin dhe mbrojtjen e segmentit të përroit në zonën e Potamit, Bashkia Himarë. Duke qenë se përroi ekzistues përbën rrjedhën natyrore të shkarkimit të ujërave sipërfaqësore të zonës dhe paraqet problematika të theksuara erozioni, degradimi të brigjeve dhe rrezik për përmytje, alternativa e zhvendosjes së gjurmës së ndërhyrjes në një korridor tjetër nuk është konsideruar e përshtatshme. Për këtë arsye është përzgjedhur alternativa e rehabilitimit dhe sistemimit të përroit në gjurmën ekzistuese, duke ruajtur funksionin e tij natyror dhe duke minimizuar ndërhyrjet në territorin përreth.

Në fazën e studimit janë analizuar alternativa të ndryshme për mbrojtjen e brigjeve dhe sistemimin e shtratit të përroit, duke përfshirë ndërtimin e mureve betonarme, veshjen e plotë të seksionit me beton, përdorimin e gabioneve dhe aplikimin e zgjidhjeve bioinxhinierike. Pas analizës së karakteristikave hidraulike, gjeoteknike, ekonomike dhe mjedisore të zonës, është përzgjedhur alternativa e ndërtimit të mureve mbrojtëse me gabiona të kombinuara me sistemimin e tabanit të përroit.

Alternativa e përdorimit të gabioneve është vlerësuar si më e përshtatshme pasi siguron fleksibilitet më të madh ndaj deformimeve të mundshme të terrenit, aftësi të mira drenazhuese, rezistencë ndaj proceseve erozive dhe integritet më natyral me mjedisin përreth. Për më tepër, kjo zgjidhje kërkon mirëmbajtje më të kufizuar dhe paraqet avantazhe ekonomike krahasuar me strukturat masive betonarme.

Alternativa e realizimit të mureve betonarme përgjatë gjithë segmentit është konsideruar më pak e favorshme për shkak të kostove më të larta të ndërtimit, ndikimit më të madh në peizazh dhe nevojës për ndërhyrje më intensive në terren. Po ashtu, alternativa e veshjes së plotë të shtratit dhe brigjeve me beton do të reduktonte karakterin natyror të përroit dhe do të krijonte ndikime më të konsiderueshme mjedisore. Zgjidhjet bioinxhinierike janë vlerësuar si të përshtatshme vetëm për segmente me intensitet të ulët erozioni, por jo të mjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e kërkuar në kushtet e prurjeve të larta dhe të problematikave ekzistuese të evidentuara në zonë.

Për sa i përket teknologjisë së ndërtimit, është përzgjedhur një zgjidhje e kombinuar që përfshin gërmimet dhe profilizimin e shtratit të përroit, realizimin e shtresave mbushëse me materiale gurore të ngjeshura mekanikisht, ndërtimin e mureve mbrojtëse me gabiona, vendosjen e shtresave të betonit për mbrojtjen e tabanit dhe realizimin e elementëve strukturorë ndihmës sipas kërkesave të projektit. Kjo teknologji siguron qëndrueshmëri strukturore, rezistencë ndaj erozionit, funksionim të sigurt hidraulik dhe jetëgjatësi të veprës.

Është analizuar gjithashtu alternativa e ndërhyrjeve minimale lokale dhe e ruajtjes së gjendjes ekzistuese me masa të kufizuara mirëmbajtjeje, por kjo alternativë është përjashtuar pasi nuk garanton rritjen e kapacitetit përcjellës të përroit, nuk eliminon proceset e vazhdueshme të erozionit dhe nuk siguron mbrojtjen e nevojshme të territorit, infrastrukturës dhe pronave që ndodhen përgjatë segmentit.

Në përfundim, alternativa e sistemimit të përroit në gjurmën ekzistuese, nëpërmjet ndërtimit të mureve mbrojtëse me gabiona dhe sistemimit të kontrolluar të shtratit, është vlerësuar si zgjidhja më e përshtatshme nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe mjedisore. Kjo alternativë garanton mbrojtje efektive ndaj përmbytjeve dhe proceseve erozive, ruajtje të karakteristikave natyrore të zonës dhe përmirësim afatgjatë të sigurisë dhe funksionalitetit të territorit në zonën e Potamit, Bashkia Himarë.

AKTIVITETE TE TJERA QE MUND TE NEVOJITEN PER ZBATIMIN E PROJEKTIT

Në fazën paraprake të punimeve mund të nevojiten aktivitete për pastrimin dhe përgatitjen e territorit, përfshirë heqjen e bimësisë spontane, sistemimin fillestar të sipërfaqes dhe përcaktimin topografik të akseve dhe kuotave. Gjithashtu, do të realizohen rievime topografike dhe verifikime

gjeometrike të vazhdueshme gjatë zbatimit për garantimin e përputhshmërisë së punimeve me projektin teknik.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe pranisë së formacioneve shkëmbore, mund të nevojiten aktivitete shtesë për stabilizimin e skarpave, mbrojtjen e territorit nga erozioni dhe largimin e materialeve të tepërta të gërmimeve. Materialet e dala nga gërmimet do të transportohen dhe depozitohen në vende të miratuara, në përputhje me kërkesat mjedisore dhe administrative në fuqi.

Gjatë fazës së ndërtimit do të nevojitet organizimi i kantierit të punimeve, përfshirë vendosjen e sinjalistikës së përkohshme, rrethimit mbrojtës, pikave të magazinimit të materialeve, zonave të parkimit të mjeteve dhe ambienteve ndihmëse për personelin teknik dhe punëtorët. Gjithashtu, mund të kërket furnizim i përkohshëm me energji elektrike dhe ujë për nevojat e kantierit dhe funksionimin e pajisjeve të ndërtimit.

Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në punë, do të zbatohen aktivitete monitorimi dhe kontrolli për reduktimin e pluhurave, zhurmave dhe ndotjeve të mundshme gjatë punimeve. Këto aktivitete përfshijnë lagjen periodike të sipërfaqeve, mirëmbajtjen e makinerive, menaxhimin e mbetjeve dhe kontrollin e kushteve të sigurisë teknike në kantier.

Gjithashtu, gjatë realizimit të projektit mund të nevojiten aktivitete për koordinimin me institucionet lokale dhe subjektet e rrjeteve inxhinierike ekzistuese, në rastet kur kërkohen lidhje të reja infrastrukturore apo ndërhyrje në afërsi të linjave ekzistuese të furnizimit me energji, ujë apo rrjeteve të tjera teknike.

Pas përfundimit të punimeve ndërtimore, do të realizohet pastrimi përfundimtar i territorit, rehabilitimi i zonave të prekura përkohësisht nga kantieri dhe sistemit përfundimtar të sipërfaqeve të gjelbëruara dhe elementëve të mobilimit urban. Këto aktivitete synojnë rikthimin e zonës në gjendje të kontrolluar funksionale dhe integrimin estetik të projektit me mjedisin përreth.

INFORMACION PER LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENSAT E NEVOJSHME PER PROJEKTIN SI DHE KOPJE TE TE GJITHE AUTORIZIMEVE, LEJEVE DHE LICENSAVE QE SHOQERIA DISPONON

Subjekti zbatues duhet të plotësojë një sërë kushtesh teknike, ligjore dhe mjedisore, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe territorit. Më poshtë paraqiten disa nga kushtet dhe kërkesat kryesore që duhet të përmbushë një kompani për të operuar:

- Të jetë subjekti i licensuar për ushtrimin e aktivitetit përkatës, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të disponojë certifikime të standardeve të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, si ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001;
- Të pajiset me Vendim për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) ose Vendim Paraprak për VNM, sipas natyrës dhe kategorisë së projektit;

- Të zbatojë masa konkrete për mbrojtjen e biodiversitetit, habitateve natyrore, florës dhe faunës së zonës;
- Të hartojë dhe zbatojë Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS/ESMP) gjatë gjithë fazës së ndërtimit dhe operimit;
- Të ndalojë depozitimin e mbetjeve, shkarkimet e pakontrolluara dhe çdo aktivitet që mund të shkaktojë ndotje të tokës, ujit apo ajrit;
- Të sigurojë menaxhimin e mbetjeve nëpërmjet subjekteve të licensuara dhe të mbajë regjistra përkatës për administrimin e tyre;
- Të kufizojë ndërhyrjet vetëm në sipërfaqet e miratuara dhe të shmangë dëmtimin e vegjetacionit jashtë gjurmës së projektit;
- Të marrë masa për kontrollin e pluhurit, zhurmave, vibrimeve dhe erozionit gjatë punimeve;
- Të garantojë rehabilitimin e zonës pas përfundimit të punimeve, përfshirë rikthimin e mbulesës bimore në rastet kur kërkohet;
- Të lejojë monitorimin dhe inspektimin periodik nga institucionet përgjegjëse mjedisore dhe territoriale;
- Të respektojë kërkesat e Ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi.
- Gjithashtu, subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës që vërteton:
- Licencat profesionale dhe teknike;
- Certifikatat ISO;
- Ekstraktin e QKB-së;
- Lejet mjedisore dhe autorizimet përkatëse;
- Kontratat me subjekte të licensuara për menaxhimin e mbetjeve;
- Dokumentacionin teknik dhe projektet e miratuara nga institucionet kompetente.

BOE “INFRATECH” sh.p.k & “EMAR 21” sh.p.k

Perfaqesues me Prokure

Ing. Filjana Veizaj